



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 270, datë 23.12.2024

**PËR
“CAKTIM TË PÛRKOHSHËM TË DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
BERAT”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktim të përkohshëm të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;



2. Neni 59 pika 1 dhe 4, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
3. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
4. Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës nr. 2731 prot., datë 20.12.2024;
- ii. Projektvendimi i formatuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Shkarkimi nga detyra i drejtuesit të caktuar përkohësisht, zotit Dritan Gripshi, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, (i cili ishte caktuar përkohësisht në këtë detyrë që pas dorëheqjes së drejtueses së mëparshme të asaj prokurorie, për shkak të zgjedhjes si anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ka vijuar ta ushtrojë atë detyrë, deri në datën e shkarkimit të tij nga KPK-ja) ka krijuar sërish pozicionin vakant të drejtuesit të kësaj prokurorie.
3. Në të tilla rrethana, Këshilli vendosi të vijojë procedurën për plotësimin e vakancës nëpërmjet caktimit të përkohshëm të një prokurori, në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
4. Në procedurën për caktimin e drejtuesit të përkohshëm janë mbajtur parasysh parashikimet ligjore si më poshtë:
 - nenin 59 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet se :

“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera;
b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.”
 - neni 42, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, “Caktimi i përkohshëm”, ku parashikohet se:

“... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”



- nenin 3 i Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, së ndryshuar, ku përcaktohet se:

“ 1.Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2.Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.”

5. Në rrethanat e mësipërme, Këshilli me vendimin nr. 42, datë 29.03.2024, ka vendosur të caktojë përkohësisht zonjën Edina Kurti të ushtrojë detyrën e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nga data 29.03.2024 deri në 28.06.2024. Këshilli, ka vijuar të ndjekë edhe më pas po të njëjtën procedurë duke e caktuar sërish përkohësisht zonjën Kurti si drejtuese të kësaj zyre prokurorie, me vendimin nr.101, dhe së fundmi me vendimin nr. 205 datë 30.09.2024, për periudhën 30.09.2024 – 29.12.2024.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

6. Përmbushja e kriterëve profesionale dhe pastërtisë së figurës nga zonja Kurti sa i përket caktimit të përkohshëm përgjatë gjithë vitit 2024, vazhdon të jetë e njëjtë edhe në këtë fazë të procedurave për caktimin e përkohshëm sërish si drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, përfshirë dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi ndaj saj. Për periudhën që do të ushtrojë këtë detyrë, saktësisht nga data 30.12.2024 deri më 29.03.2025, zonja Kurti do të përfitojë pagën e drejtuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Edina Kurti, aktualisht, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
2. Zonja Edina Kurti do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nga data 30.12.2024 deri më 29.03.2025.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zonja Edina Kurti do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.



4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Edina Kurti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.12.2024.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla